



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KËSHILLI I BASHKISË MEMALIAJ

Nr. 2350 / prot.
13

Memaliaj më 27.10. 2025

Procesverbal

I mbajtur sot më datë 27.10.2025 në sallën e Këshillit në katin e parë të bashkisë Memaliaj.
Ora e fillimit të mbledhjes 10:10.

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e fillimit 11 këshilltarë.

Kryesues i mbledhjes Z. Erjon Sinanaj/ Kryetar.

Mbledhja deklarohet e hapur. Njohja me rendin e ditës. Përsëri vazhdon e njëjta situatë ku administrata nuk sjell asnjë projekt vendim për vendimmarrje në këshill.

● Pika e parë e rendit të ditës.

Miratimi i rendit të ditës.

Vota Pro 11 vota.

Vota Kundër 0 vota.

Vota Abstenim 0 vota. Miratohet.

● Pika e dytë e rendit të ditës. Miratimi I procesverbalit të datës

Hidhet në votim.

Vota Pro 11 vota.

Vota Kundër 0 vota.


Vota Abstenim 0 vota. Miratohet.

Petrit Lumani: Dua të flas për problematikat që shoh këtu se e di që asgjë nuk do bëjmë por është kënaqësi që shohim të pranishëm në këtë mbledhje nëprefektin. Këtu shoh disa bashkëfshatarët e mi nga Qesarati ,para se të fillojmë ti dëgjojmë çfarë shqetësimi kanë . Dua që ta dinë të gjithë qytetarët se mbledhjet janë për qytetarët dhe le të vinë të ngrenë shqetësimet e tyre, për këtë na vjen mirë.

Faleminderit kryetar që ma dhe fjalën, njëkohësisht e prisnim prej kohësh prefektin për një situatë që e kemi vënë në dijeni me shkresa për një situatë jo korrekte nga bashkia.

Asqeri Muçoima: Jam dakord me kolegun , këtu kemi rendin e ditës ku për fat të mirë kemi një pikë ku thuhet: Raportim nga njësitë administrative ,pra kur të vemi te kjo pikë e do të vemi shumë shpejt pasi pika 3 dhe 4 mesa shoh unë nuk kanë materiale. Le të dëgjojnë dhe ata se çfarë ka pika 3 dhe 4 dhe le ta marrin vesh dhe qytetarët, problemet që ka sjellë bashkia, ngërçit që është midis institucionit të këshillit dhe administratës së bashkisë.

Kryetari/ Faleminderit profesor! Unë po vazhdoj me pikën 3 dhe 4 dhe pastaj ti kaloj fjalën qytetarit. Largohet nga mbledhja Znj. Lauresha Lila.



Pika 3. Kemi projekt vendimet e munguara nga ana e bashkisë, për këtë arsye është bërë kërkesë nga ana jonë si këshill për të qenë i pranishëm dhe Prefekti i qarkut në mbledhje, për shkak të ngërçit institucional të krijuar në këshill prej 4 muajsh për mosparaqitjen e materialeve përkatëse. Nga ana e Prefektit të Qarkut kemi sot të pranishëm në këtë mbledhje Z. Avni Lala/ Nënprefekt sipas kërkesës së bërë nga ana jonë si këshill për të qenë i pranishëm në mbledhjen e Këshillit Bashkiak.

Xhevit Kacorri: Unë do të kisha një pyetje pasi nuk mund t'i kaloj pa marr një informacion se si funksionon shpërndarja e ndihmës ekonomike, të na japi një informacion bashkia? Si funksionon ndihma ekonomike, nëse ka mbështetje ligjore?

Kryetari/ Erjon Sinanaj: Është një pyetje që duhej t'i bëhej administratës e cila duhej të ishte e pranishme këtu, por nuk i kemi të pranishëm prej 4 muajsh.

Esmerald Xhemali: Po diskutohet fjala "ngërç". Dua të di se ç'do të thotë "ngërç"? E kam dëgjuar disa herë të artikuluar këtë fjalën ngërç se më ka ardhur dhe në shkresë kjo fjala ngërç, mos e përdorni vend e pa vend.

Taulant Rama: I nderuar Kryetar! Të nderuar kolegë! Unë po shfrytëzoj rastin meqenëse jemi dhe live, kemi dhe përfaqësues të prefekturës, po më bëhet qejfi që kemi dhe qytetarët, për mos të përmendur fjalën ngërç se nuk do Esmeraldi, ne kemi 4 muaj që kemi një situatë të pazakontë e cila është e paprecedentë. Unë nuk dua të bëj politikë këtu, jam munduar të mbaj qëndrime dhe pse kam dëgjuar historira dhe mua më duket një Haxhiqamilizëm modern kjo që po bën administrata dhe kryetari i bashkisë Memaliaj. Pra topi është i imi dhe penalltinë e gjuaj vet dhe në kundërshtim me çdo lloj ligji që është në fuqi. Ju kryetar e thatë shkarazi pikën 3 dhe 4 po opinionin publik nuk e dinë kush janë pikat 3 dhe 4 dhe as qytetarët janë këtu, përveç kësaj unë dua ta theksoj sepse nga administrata e bashkisë është përcjellë në të gjithë opinionin publik të paktën përse unë kam dijeni se qenkësh këshill shkaktar i çdo gjëje vendimmarrëse të bashkisë sepse këshilli bashkiak gjoja su mbledhka që ta dëgjojnë të gjithë meqenëse janë dhe zotërinjtë këtu që përfaqësojnë qytetarët dhe le ta dëgjojnë të gjithë që nga momenti që pretendon administrata e bashkisë këshilli është mbledhur 2 herë në muaj përjashtuar këtë muaj. Jemi në kushtet ku administrata kërkon të kontrollojë këshillin bashkiak duke mos njohur aspak ligjin që t'ia prezantojmë dhe përfaqësuesit të prefekturës se ndoshta nuk ia kemi shpjeguar kaq qartë në shkresë duke tejkaluar nga ana e kryetarit dhe administrata ligji, ku unë po çuditë me mos reagimin nga ana e institucioneve kompetente, përfshirë dhe ne. Kjo punë dhe në rastin e shpërblimit të këshilltarëve, kryetar janë marrë kompetencat tuaja dhe të sekretarit të këshillit ashtu siç e përcakton ligji dhe rregullorja e Këshillit. Nuk ka të drejtë kryetari i bashkisë të ndërpresë shpërblimin, është vepër penale. Tjetër për opinionin publik kemi pikën 3 që është dhënia e ndihmës ekonomike 6 % për muajin shtator 2025. Procedohet që bashkia e sjellë projekt vendimin dhe ne e miratojmë. Ka 4 muaj që nuk janë sjellë nga bashkia ndërsa qytetarët përcillen duke u thënë se nuk mblidhet këshilli, kështu që ne duhet të mbajmë qëndrim publik. Po ju lutem meqenëse kemi dhe përfaqësuesin e prefekturës kështu nuk vazhdohet për të mirën e qytetarëve. Pa unë personalisht nuk e kam problem fare as për të qenë anëtarë këshilli po e mira e qytetarëve është tjetër gjë sepse kanë 4 muaj që nuk po marrin ndihmën ekonomike dhe bashkia s'po reagon dhe na dalin me historira festivalesh. Kaq kisha. Faleminderit!

Kryetari i këshillit: Faleminderit Taulant siç the unë i rashë çik shkurt dhe për të mos ngrenë dhe kohën e pjesëmarrësve po po dhe ngaqë këtë e kam bërë dhe në mbledhjet e tjera megjithatë të falënderoj dhe ia jap fjalën Z. Nënprefekt të cilin e kemi të pranishëm këtu.

Avni Lala / Nënprefekt i Qarkut: Ju përshëndes të gjithëve dhe ju uroj punë të mbarë në këtë institucion që jeni zgjedhur me votën e popullit. Pjesëmarrja ime sot këtu është në bazë të një shkrese që është dërguar nga ana juaj si këshill për marrjen pjesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak ku është

krijuar një problem, një mosfunksionim , një mos zbatim të ligjit. Në prefekturë nga juaj mund të them që është shkresa e 3 apo e 4 që është dërguar nga ju dhe prefekti e ka marrë seriozisht dhe ju ka dërguar një përgjigje institucionale, nuk e di kryetar, përgjigja e prefektit u është lexuar këshilltarëve.

Kryetari i këshillit: Po ,janë njohur këshilltarët.

Avni Lala: Duke marrë parasysh si këshilli bashkiak dhe bashkia janë dy institucione të pushtetit vendor duhet patur parasysh që të vihen në shërbim të qytetarëve. Kjo problematikë që po ndodh këtu në këshillin bashkiak Memaliaj për mosfunksionimin se kush është fajtori këshilli apo administrata duhet një rrugë gjyqësore. Nga ana e prefekturës për shqetësimin tuaj dhe problemin tuaj është përcjellë dhe në ministrinë e brendshme dhe atë të ministrisë të pushtetit vendor dhe është dhënë një përgjigje e vonuar sepse jeni pushtet lokal, jeni autonom , këtu po ndëshkohet komuniteti. Komuniteti që ju ka votuar po merr një ndëshkim maksimal , ku po u pritet edhe ajo buka e gojës ,ajo asistenca 30 mijë lekë të vjetra apo sa është vlëra. Para se të vija këtu kam shkuar te zyra e kryetarit të bashkisë sepse duhet të bashkëpunojë administrata dhe këshilli bashkiak në bazë të ligjit për interes të komunitetit. Kryetari pretendonte se është kërkesa e dytë që ka bërë për mbledhje jashtë radhe për arsyen që këshilli ka kthyer përgjigje dhe me shkresë . Nga ana juaj është hera e katërt që bëhet kërkesë për mbledhje dhe është refuzuar kërkesa nga ana e administratës. Kërkesat për të sjellë materiale jo vetëm për ndihmat ekonomike dhe prapë është refuzuar nga ana e administratës së bashkisë atëherë cila është rruga ligjore. As prefektura dhe as ministria nuk mund të bëjnë një ligj saksion e cila të detyrojë administratën ose të detyrojë këshillin por është e bazuar në ligj sepse sikur të vij ligji nga prefektura sepse cenohet pushteti vendor. N.q.se administrata e kryetarit të bashkisë pretendon se ka shkelur ligjin këshill bashkiak dhe do ti drejtohet rrugës administrative. Të njëjtën gjë dhe këshilli bashkiak për mosfunksionim , për mosparaqitjen e materialeve nga administrata dhe për mosmarrjen e lekëve ai komuniteti. Këshilli Bashkiak ka fondet e veta të thërrasë një avokat , bëni një kërkesë dhe nëse nuk u kthejnë përgjigje mban secili përgjegjësitë ligjore.

Taulant Rama: A ka KLSH?

Avni Lala: Edhe KLSH do të ndërhyjë me urdhër të prefektit kam ardhur këtu mendoj se do të jetë mbledhja e fundit se përsëri prefektura do ti drejtohet Ministrisë së Mbrojtjes, Kryeministrit, Ministrit të Pushtetit vendor po ju si këshill ti keni të dokumentuara kërkesat para mbledhjes të çdo të çdo muaji. A ju ka ardhur ndonjë përgjigje nga administrata për çfarë arsye administrata nuk sjell materiale.

Erjon: Ne kemi komunikuar me Prefekturën me anë të shkresave dhe ato janë bërë të qarta.

Avni Lala: Prefekti më dërgoi që mora pjesë dhe prefektura do të bëj punën e saj drejt Ministrit të Mbrojtjes, Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Kryeministrit por ju sygjeroj që ju takoni në gjykatë problemin. Atëherë gjykata vendos por nuk duhet të presin qytetarët. Unë ju këshilloj për një bashkëpunim.

Taulant Rama: Është rast i paprecedent që ka ndodhur ndonjëherë nuk gjej një rast që të kontrollojë bashkia këshillin bashkiak, ndërkohë që duhet të jetë e kundërta.

Xhevit Kacorri: Është një koordinator i BtF, pse nuk koordinon ai?

Afize Sula: Këshilli Bashkiak ka qenë këtu , është këtu. Këshilli Bashkiak është i hapur për t'i shërbyer qytetarëve.

Riza Lama: I nderuar Z.Kryetar , Nënprefekt, këshilltarë vij nga fshati Qesarat Riza Lama më quajnë. Dy probleme kisha ujin dhe rrugën e fshatit Qesarat. Janë 10 - 15 familje që e mbanin ujin me bidon për të bërë bukën vaj hallin për t'u larë se nuk lahen ndonjëherë, si mund të ndërhyjë bashkia të bëj një pus? Ujësjiellësi është hapur një kanal i madh e i mbajmë sytë nga kanali. Kalon lumi ,ujë s'kemi.

Adresa: Bashkia Memaliaj, Rruga "Tafil Buzi" godina nr 7- Kodi Postar 6302 www.memaliaj.gov.al e-mail: info@bashkiamemaliaj.gov.al

Kalon xhadja në fund të këmbëve në fshat s'vjen . Jemi fshati i vetëm që paguajmë më shumë taksa e një çezëm fshati duam. Faleminderit! Mirupafshim!

Kryetari i Këshillit: Kërkesën e qytetarit do ta përcjellim.

Avni Lala: Nëse një qytetarë e ngre zërin ne duhet të ruajmë qetësinë.

Petrit Lumani: Unë përfitoj nga fakti që është këtu përfaqësuesi i prefekturës do të doja të ishte këtu dhe Këshilli i Qarkut pasi kryetari është dhe anëtar i Këshillit të Qarkut nga ana tjetër fakti që ishin dhe qytetarët duhet të ishte njëçik më e civilizuar pavarësisht se Baftjari ashtu e ka natyrën dhe i ndikuar ishte meqë ra fjala nuk ka ardhur për të zgjidhur problemin këtë po është puna e tij ,por doja ti drejtohesha nënprefektit ju thatë se se vajtëm te kryetari i bashkisë dhe duam të dimë nëse ju ia ngritët një shqetësim të vogël se kush është arsyeja. Ku e gjen këtë fuqi ai të pengojë dhe të pengoj administratën në punën që ai e ka për detyrë ta bëj?

Avni Lala: Arsyeja është bërë e njohur që 3 muaj më parë kur ju i keni nisur një shkresë prefekturës dhe ai vazhdon të këmbëngulë për një mbledhje jashtë radhe që ju nuk e keni pranuar duke i kthyer përgjigje negative kërkesës së tij.

Afize Sula: Ai mund të ketë kërkuar një mbledhje jashtë radhe po mbledhja jashtë radhe kërkohet për një arsye madhore kur nuk ka arsye madhore është e drejtë të mos pranohet. Kryesia e Këshillit e shqyrton dhe kthyen përgjigje.

Avni Lala: I jam drejtuar forcërisht dhe miqësisht se këtu nuk po ndëshkohet as kryetari i bashkisë as kryetari i këshillit por qytetari. Mosfunksionimin e paguan qytetari nuk ka sens ligjor. Ai këmbëngul përsëri do ti drejtohet pjesës ligjore dhe ju do ti drejtoheni pjesës ligjore. Ne si institucion do ti drejtohem përsëri me shkresë ministrisë përkatëse dhe Kryeministrit.

Afize Sula: Bashkia ngatërron detyrat , kompetencat e këshillit janë kompetencat e këshillit . Pretendon bashkia ti kërkojë llogari këshillit ndërkohë që duhet të ndodhi e kundërta deri këtu ka arritur bashkia Memaliaj kundrejt këshillit bashkiak. KB është i përgjegjshëm edhe kur dje, pardje para se të ndodhte kjo situatë. Ata ishin me probleme në dokumentacioni i kemi këshilluar , i kemi mirëkuptuar për të mos penguar atë popullin ,ata banorët që janë me probleme nga më të shumtat për mos u bërë pengesë i kemi mirëkuptuar dhe i kemi kaluar me radhë , tani ka ardhur përballë faktit se kur i mirëkupton shumë edhe nga ana e përgatitjes së materialeve se as materiale nuk ishin që në krye të herës nga ana e bashkisë. Ata sot vinë dhe pretendojnë të kontrollojnë këshillin. Ku është problemi nëse ka pasur kërkesë nga ana e kryetarit të bashkisë për mbledhje jashtë radhe dhe ka qenë një emergjencë dhe nuk është konsideruar nga ana e kryesisë së Këshillit bashkiak atëherë hajde ta diskutojmë, të vemi dhe në gjykatë po ti tekton kryetarit të bashkisë se thjesht do të ndryshojë të arrijë një synim që është normale mund ta bëjë në mbledhjen e radhës është normale. S'ka pse të krijojë kaq shumë kakofoni atëherë ky është problemi i tij që u nxjerrë pastaj problem qytetarëve dhe nuk ka në vëmendje absolutisht te asnjë qytetar. Në fokus nuk është qytetari për të. Kaq. Nuk ia faturon dot këtë problem këshillit bashkiak sepse KB është këtu.

Avni Lala: Faleminderit përsa na shpjegove, KB nuk është në varësi të Kryetarit të Bashkisë, është organ i zgjedhur, është institucion më i lartë se bashkia dhe kryetari i bashkisë. Nuk mund të arrijë kryetari i bashkisë ti kërkojë llogari këshillit sepse këshilli e merr në raport kryetarin e bashkisë sepse çdo gjë sot në bashki bëhet me votat e KB , ai që se kupton ligjin do të ndëshkohet.

Taulant Rama: Doja të shtoja diçka në detaje për kërkesën meqë kryetari e përmendi, tani madje në mënyrë informale kryetari i bashkisë ka thënë ata duhej të mblidheshin kur doja unë jo tani kur duan ata , deri aty ka arritur, madhështia por megjithatë i nderuar Z.Nënprefekt ideja është se përveç dëshirës dhe të më falni për shprehjen, epsheve psiqike që kanë këta për të kontrolluar këshillin e për të bërë historira. Unë po ju marr një rast për ta kuptuar dhe ju gjithë këtë mesele ka ardhur për shkak

të një shkresë që ka ardhur e që kërkonte një mbledhje jashtë radhe jo emergjente se për emergjencë jemi të detyruar, por për një mbledhje jashtë radhe në 4 korrik për të njëjtin vendim që në datën 30 qershor nga Këshilli nuk është miratuar por më e bukura qershia mbi tortë se thotë dua ta bëj këtë mbledhje . Ndërkohë që ligji thotë të kërkojë mbledhje jashtë radhe duhet ta argumentosh pra kush është argumenti dhe bashkia kaq e përndritur që do të na hedhi në gjyq thotë në shkresë e kërkojmë këtë mbledhje jashtë radhe për shkak se është e domosdoshme dhe ligji e thotë se kryesia e Këshillit n.q.se nuk ka argument nuk duhet të bëj mbledhje jashtë radhe. E dyta ka një procedurë për mbledhje jashtë radhe që zgjat 15 ditë pune që nga data 4 korrik që ka ardhur kërkesa nga zotëria që do të na hedhi në gjyq dhe bujrum se do të shkoj vetë ta mbrojë këtë punë pa avokat. Që nga data 4 korrik deri në datën 15 nuk bëhen 15 që përkon me caktimin e mbledhjes së radhës s'ishin 15 ditë pune . Zotëria dhe zotërinjtë kanë nxituar aq shumë sa për 10 ditë kanë shpallur sabotim , kanë shpallur grevë në këto kushte unë lam një vërejtje për ju. E para qenë se ata ua kanë konfirmuar personalisht, kryetari i bashkisë që unë po sabotoj këshillin në dijeninë time ju ka dërguar dhe një shkresë që këshilli nuk "mbledhet " dhe ai po bën protestë. A e konsideron Prefekti bazuar në ligj, pra juristët tuaj e konsiderojnë këtë akt të bashkisë si një vetëgjyqësi. Pse duhej të na bllokonte ai ne le të na çonte në gjyq.

Avni Lala: Po të kthehej përgjigjen e parë, shkresa që ka ardhur nga KB i është kthyer përgjigjia me jurist dhe iu është lexuar juve në mbledhje. A ju është lexuar?

Taulant Rama: Po. Unë e kam dhe fizikisht shkresën.

Avni Lala: Mbajini të gjitha ato shkresa se me ato do të përballeni në gjyq.

Taulant Rama: Unë dua përgjigje a konsiderohet kjo vetëgjyqësi apo jo?

Avni Lala: Nuk ta kthej dot këtë përgjigje atë ta thotë vetëm gjykata. Nuk ta thotë Prefekti atë po i është drejtuar dhe kryetarit të bashkisë dhe këshillit bashkiak.

Taulant Rama: E dyta juthatë se cenohet autonomia e pushtetit vendor nëse ndërhyr qeveria ashtu po cenohet dhe funksionimi i këshillit bashkiak. Nuk ka një mekanizëm që kontrollon përveç KLSH- së etj.Situata është serioze. Ka institucion kontrolli.

Avni Lala: Nuk veprohet pa një vendim gjyqësor.


Esmerald Xhemali:Mendoj mos ta zgjasim më se u kthye në një séance pyetje-përgjigje me zotërinë.

Ai që në krye të fjalës e sqaroi pozicionin dhe e sqaroi problematikën dhe e mbylli kur tha se kjo punë duhet zgjidhur me gjykatë.Kemi 4 muajqë bëjmë reterika. Pse ai kështu?Pse ne ? etj. Ja që ndodhi tani jemi para faktit nuk është as mbledhje e pare dhe ma do mendja nuk do të jetë as mbledhja e fundit që ne vimë këtu dhe bëjmë gjyqe kështu publike, imagjinare. Ne jemi përpara faktit dhe u bëj thirrje kolegëve të ngrihen në lartësinë e detyrës dhe atyre që kemi marrë përsipër duke filluar që nga anëtarët e komisioneve,kryetarët e komisioneve të shohin çfarë thotë ligji, çfarë thotë rregullorja dhe të ndërrmarim ne nisma ligjore që të jemi ne në rregull me atë ndërgjegjen tonë. Vjen qytetari i acaruar për një problem ,ne nuk mund ta kalojmë në personale ,ai ngre zërin, ngriti problemin e ujit. Kush e pengoi këshillin që komisionet përkatëse, qoftë ai ni financës , qoftë ai I infrastructures se është e drejtë që ta jep ligji që ta ushtrosh. Në nenin 36 të rregullores pot a lexosh komisioni vete dhe kontrollon punën , e thërret nuk të vjen ,vete vetë atje dhe i thua: Çfarë po bëhet?

Afize Sula: e dërgon me shkrim e orienton shqetësimin e qytetarit.

Esmerald Xhemali:E mora të mirëqënë shqetësimin e qytetarit se qytetar jam unë dhe unë pa ujë jam . Nuk më intereson procedura se sa më intereson problemi i qytetarit.

Petrit Lumani:Ata qytetarët unë i njoh i kam miqtë e mi. Nuk na mungon intelektualiteti dhe zemërgjerësia , aftësia e zgjuarsia ata dikush i ka nxitur është e thjeshtë se s'erdhi tek unë po vajti te ai që quhet "Vandami". O burra u bini se morën shkas nga Vlora.



Largohet nga mbledhja Z. Esmerald Xhemali.

Asqeri Muçoima: Gjë e mirë që sot ka ardhur nënprefekti në emër të prefektit, kjo duhej të kishte ndodhur më përpara është e pafalshme të vimë këtu dhe të mos marrim një vendim për komunitetin. Ç'është mbledhja e këshillit? Prefekti na thotë kjo zgjidhet me gjyq na thotë prefekti. Si zgjidhet me gjyq? Të yemi në të hedhim në gjyq kryetarin e bashkisë? E hedhim në gjyq se nuk na bie dokumentacion? Kur ka ndodhur kjo dhe kush e paguan kjo dhe kush e paguan? Jo n.q.se kryetari thotë do ti hedh në gjyq dhe ai vet nuk vete dot dhe nuk na akuzon dot për një çështje të tillë. Kjo është e papranueshme dhe këtë nuk duhet ta pranoj as prefektura, këtë vendim të atij si mund të ndodh unë këtë nuk e kuptoj. Pyesni këdo nga juristët dhe do të habiten se nuk e ke të shkruar as në ligjin e pushtetit vendor, të shkruar as në atë të kodit të procedurës etj. Por prefektura, unë e kam shprehur pakënaqësinë time kryetar edhe në mbledhjet e tjera. 1. Prefektura 2. Këshilli i Qarkut 3. Ministria e Brendshme 4. Sekretari i Përgjithshëm i Kryeministrit mund të kishin marrë masa jo për ne por për ata njerëzit. Kishte hedhur kryetari i bashkisë në FB një takim me shoqatën e bashkive, bravo i qoftë se dhe ata i paskan bërë nder dhe për bashkinë tonë mirë është se nuk është e paktë dhe atje kërkoi më shumë autonomi për pushtetin vendor po shumë bukur. Po ky që kërkon atje lart autonomi me ç'kurajo vjen këtu dhe kërkon të vendosi mbi këshillin bashkiak ku dihet që organi i Këshillit bashkiak është më lart se kryetari i bashkisë. Prefektura duhet të jetë më në dijeni të problemit që ne kemi ngritur. Siç erdhi sot le të vinë juristët e Prefekturës se nuk kemi jurist këtu. Nuk i lë kryetari dhe administrata duhet të veprojë sipas ligjit duhet t'ia bëjë me dije dhe kryetarit. Ndërkohë qytetarit i thotë s'janë mbledhur këshilltarët, ne jemi mbledhur nga dy herë në muaj. Ndërsa ju thoni do të dëgjojë, jeni me vonesë. Ju duhet të bëni një takim me kryetarin ke këto shkelje. Unë po të paralajmëroj n.q.se brenda 15 ditëve nuk e çon dokumentacionin. A do paketa e maleve për ta kaluar në këshill? Po si kjo ka dhe plot të tjera. Janë bursat që duan kaluar se digjen. Si duhet vepruar në këto raste? Këtë problem se kam dëgjuar në asnjë bashki.

Avni Lala/ Nënprefekt: Për këtë problem është bërë një takim në prefekturë me kryetarin e bashkisë. Për të vënë në prioritet interesin qytetar pastaj ai të vazhdojë gjyqet.

Asqeri Muçoima: Po duhet të dish dhe ca gjëra të tjera, ja mu më është prerë shpërblimi dy muaj rresht. Lam marrë leje të kryetari i këshillit pasi kam qenë i sëmurë dhe i kam dokumentacionet. Në gjyq do ta hedh unë atë pasi më ka bërë padrejtësi jo të më hedhi ai mua. Përse do të më hedh në gjyq? Përse do të më akuzoi? Ky është shantazh i hapur. Nuk e kuptoni juve? Ai do të na mbyll gojën ne këshilltarëve sepse nuk kaloj X dokument që ishte antiligjor dhe ajo që kërkon ai mbledhje jashtë radhe ka afat kohor. Ajo pikë ishte trajtuar dhe është votuar kundër në mbledhjen e kaluar të Këshillit. Ai thotë dua unë tani. Si e toleroni ju? Kjo është e patolerueshme. Ju thoni ikni në gjyq. Le të vij KLSH -ja aty do të shohim do të zbuloni xhevaire, xhevaire do të zbuloni. Po deputetët çfarë bëjnë?

Avni Lala/ Nënprefekt: Mos I ngatërro deputetët me problemet e Këshillit Bashkiak profesor. Largohet nga mbledhja Znj. Arsola Muzha.

Xhevit Kacorri: Unë do të thosha këtë në raport me situatën, ne i kemi dërguar shkresë para 3-muajsh prefektit. Ndërkohë këtu jemi duke ushtruar detyrën në bazë të ligjit dhe ata janë në shkelje flagrante të ligjit. Juve pse nuk merrni masa? Po na vini ne përballë gjyqit kur ai nuk po e kryen detyrën?

Avni Lala/Nënprefekt: Kur zbrita poshtë kryetari më tha: Po ju pse nuk e detyroni atë këshillin? Absolutisht jo nuk mund të ushtrojmë presion mbi këshillin bashkiak.

Xhevit Kacorri: Ju thoni çojë në gjyq po unë s'jam privat, jam institucion dhe u drejtohem institucioneve. Unë propozoj e sygjeroj që për të dal nga kjo situatë të bëhet një marrëveshje për të

zgjdhur këtë mosmarrëveshje. Të bëjmë një ramboje mendoj unë. Kryetari i bashkisë të takohet me kryetarin e këshillit ose me kryesinë e Këshillit

Erjon Sinanaj/Kryetari i këshillit: Ju falënderoj për fjalën. Unë dua të falënderoj dhe Nënprefektin për pjesëmarrjen dhe shpresoj ardhja juaj këtu do ti japi frytet e saj. Përsa i përket pikave 3 dhe 4 që duhet të ishin prezentë dhe s'janë nuk kemi ç'të bëjmë më.

Taulant Rama: Përse nuk marrim një vendim që ta detyrojmë ti sjellë?

Erjon Sinanaj: E kemi bërë e kanë bërë dhe Komisionet përkatëse që kanë dal me vendim.

Taulant Rama: Për pikën 5 dhe 6 dua të bëjmë një vendim se nuk është në dëshirën e kryetarit dhe administratës të sjellë apo jo materiale. Neni 64 thotë kryetari përgatit materiale sipas njoftimit të Këshillit Bashkiak. Pra, ai është i detyruar.

Petrit Lumani: Se urdhëroj dot unë atë se po bëjmë dhe ne si ai tani.

Taulant Rama: Administrata është duke shkelur ligjin duke mos plotësuar detyrat ndaj komunitetit .

Erjon Sinanaj: Kjo situatë ishte dhe në këtë mbledhje. Ne i kemi ndjekur hapat ligjor dhe do të vazhdojmë duke u mbështetur në ligj dhe në Rregulloren e brendshme të Këshillit Bashkiak. Para se ta mbyll po ju njoh me deklaratën që më dorëzoi Z.Xhevit Kacorri gjatë mbledhjes. Deklarata bashkangjitur këtij procesverballi.

Mbledhja deklarohet e mbyllur.

Këshilltarë pjesëmarrës në mbledhje.

1. Erjon Sinanaj
2. Petrit Lumani
3. Asqeri Muçoima
4. Afize Sula
5. Taulant Rama
6. Irena Jaupi
7. Anest Halili
8. Lauresha Lila
9. Xhevit Kacorri
10. Arsola Muzha
11. Esmerald Xhemali

Sekretari i Këshillit
Erjola Allka



Kryetari i Këshillit
Erjon Sinanaj

